



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2. pika d, nenit 14 , paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 paragrafet 10.2 dhe 10.3 të Ligjit Nr.02/L-26 për Token bujqësore , nenit 8 paragrafit 8.4 dhe nenit 9 të Udhezimit administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e tokës bujqësore si dhe nenit 20 paragrafi 20.1, dhe Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 dt.26.09.2008 Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur më 30. 04.2018 pas shqyrtimit të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, miratoi këtë :

V E N D I M P E R N D Ë R R I M I N E D E S T I N I M I T T Ë T O K Ë S

Neni 1

I. Miratohet Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Neni 2

II. Sipas pikes I të këtij vendimi toka me destinim bujqësor , parcelat kadastrale
P-71409012-00334-1 arë e klasit 6 në sipërfaqe prej 21500m²,
P-71409012-00334-3 arë e klasit 6 në sipërfaqe prej 47824m²,,
P-71409012-00335-0 arë e klasit 6 në sipërfaqe prej 202810m²,,
P-71409012-00337-0 arë e klasit 6 në sipërfaqe prej 7439m²...ZK Dobrajë e Madhe

P-71409061-00010-0 arë e klasit 6 në sipërfaqe prej 23891m²,,
P-71409061-00021-2 arë e klasit 5 në sipërfaqe prej 138913m²,
P-71409061-00035-0 arë e klasit 5 në sipërfaqe prej 101904m²,
P-71409061-00036-0 arë e klasit 5 në sipërfaqe prej 68868m²,
P-71409061-00037-0 arë e klasit 4 në sipërfaqe prej 71800m²,
P-71409061-00038-0 arë e klasit 4 në sipërfaqe prej 53491m²,
P-71409061-00040-0 arë e klasit 3 në sipërfaqe prej 6313m²,
P-71409061-00041-0 arë e klasit 3 në sipërfaqe prej 18268m².....ZK Rufe i Ri

P-71409081-00294-0 arë e klasit 5 në sipërfaqe prej 173074m²,
P-71409081-00295-0 arë e klasit 5 në sipërfaqe prej 27574m²,.....ZK Rufe I Vjeter

P-71409086-00001-2 arë e klasit 6 në sipërfaqe prej 54971m².....ZK Torinë

Në sipërfaqe totale prej $S = 1018640m^2 = 101.86.40ha$, në pronësi të Mohamammad Yousef Al Tarawneh Nr.ID.9691033260 me adresë P.O.Box 49242 Amman 11953 Jordan, me të drejtë posedim individual nën qirambajtje 99 vite.

Neni 3

Parcelat kadastrale të cekura ne pikën II të këtij Vendimi në Planin Zhvillimor Komunal 15Nr.12514 dt.23.08.2013 percaktohen si toka ndërtimore, dhe të njëjtat do të jenë pjesë e procesit të vlerësimit dhe hartimit të Planit zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës.

Neni 4

Kompenzimin për ndërrimin e destinimit të tokës të cekur në nenin 2 të këtij Vendimi do të paguhet në procedure administrative të marrjes së lejës së ndërtimit sipas dispozitave të nenit 14 paragrafi 14.2. pika a dhe b të Udhëzimit administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Neni 5

Obligohet investitori që implementimin e këtij Vendimi ta realizoj në afat prej dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi që nënkupton zhvillimet procedural sipas nenit 2 dhe nenit 4, në të kundërtën nese brenda afatit prej 2 viteve nuk i përfundon procedurat e parapara sipas këtij Vendimi, ky Vendim do të shfuqizohet dhe nuk do të ketë fuqi juridike

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtorati për planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, drejtorati për Zhvillim Ekonomik si Organet tjera të Administratës komunale do t'i kryejnë veprimet përkatëse nga përgjegjësitë e tyre me qëllim të zbatimit të këtij Vendimi.

Neni 7

Pas marrjes se Vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi do të kerkohet Pëlqimi nga MBPZHR për parcelat kadastrale të cilat janë te regjistruara si arë e klasit 3 dhe 4 dhe Pëlqimi përfundimtar nga MMPH.

Neni 8

Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi 1Nr.464-842 dt.23.09.2009 për ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore me qëllim të implementimit të projektit Ideor Urbanistik të qytetit të "Agrobiznesit" Ulpiana.

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 941-28084
Lipjan, më 02. 05. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

